

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shtator 2020


Tiranë, më 23 Tetor 2020: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Shtator 2020, janë 604.703. Krahasuar me Shtator 2019, ky tregues rezulton me rënie 43,1 %.

Në Shtator 2020, hyrjet e shtetasve të huaj në territorin shqiptar janë 377.033. Krahasuar me Shtator 2019, ky numër ka rënë me 36,2 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri në nëntëmujorin 2020 është 2.122.202, duke rënë me 61,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Përgjatë nëntë muajve të 2020, Kosova ka rënien më të ulët të hyrjeve të shtetasve në Shqipëri me 45,2 %, ndërsa rënien më të madhe e ka pasur Spanja me 90,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig.1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Shtator 2020



Për publikim 23/10/2020

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori shqiptar, gjatë muajit Shtator 2020 janë 706.145, duke shënuar një rënie me 44,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shtator 2020 janë 271.586. Krahasuar me Shtator 2019, ky numër ka rënë 51,7 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shtator 2020, janë 434.559. Krahasuar me Shtator 2019, ky numër ka rënë 39,2 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në nëntëmujorin 2020, është 2.208.821 duke rënë 50,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Shtator 2020

Periudha	Shtator 2019	Shtator 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shtator 2019	Janar-Shtator 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	1.063.358	604.703	-43,1	9.645.999	4.134.941	-57,1
Shqiptarë	471.944	227.670	-51,8	4.183.997	2.012.739	-51,9
Të Huaj	591.414	377.033	-36,2	5.462.002	2.122.202	-61,1
Dalje Gjithsej	1.277.023	706.145	-44,7	9.721.454	4.320.664	-55,6
Shqiptarë	562.574	271.586	-51,7	4.461.255	2.208.821	-50,5
Të Huaj	714.449	434.559	-39,2	5.260.199	2.111.843	-59,9

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj, Shtator 2020

Shtetet	Shtator 2019	Shtator 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shtator 2019	Janar-Shtator 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	166.207	239.353	44,0	2.004.979	1.099.278	-45,2
Maqedoni	117.841	59.669	-49,4	638.310	298.350	-53,3
Greqi	46.960	5.840	-87,6	448.222	172.830	-61,4
Itali	35.112	10.909	-68,9	381.870	100.013	-73,8
Angli	10.431	4.247	-59,3	105.397	43.325	-58,9
Mali i zi	30.531	16.584	-45,7	270.762	118.366	-56,3
Poloni	23.238	1.422	-93,9	128.552	23.505	-81,7
SHBA	10.431	3.136	-69,9	101.496	18.760	-81,5
Spanjë	3.959	388	-90,2	24.983	2.501	-90,0
Gjermani	24.642	2.812	-88,6	140.426	31.542	-77,5
Zvicër	5.392	783	-85,5	55.345	12.752	-77,0
Të tjera	116.670	31.890	-72,7	1.161.660	200.980	-82,7
Gjithsej/Total	591.414	377.033	-36,2	5.462.002	2.122.202	-61,1

Tab.3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Shtator 2020

Periudha	Shtator 2019	Shtator 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shtator 2019	Janar-Shtator 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	591.414	377.033	-36,2	5.462.002	2.122.202	-61,1
I. Personale	582.740	367.289	-37,0	5.388.791	2.040.544	-62,1
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	566.935	358.820	-36,7	5.221.811	1.984.518	-62,0
2. Qëllime fetare	56	18	-67,9	678	217	-68,0
3.Udhëtarë transit	15.749	8.451	-46,3	166.302	55.809	-66,4
II. Biznes dhe profesionale	8.674	9.744	12,3	73.211	81.658	11,5

Tab.4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Shtator 2020

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Shtator 2019	148.561	76.018	838.779	192.215	111.839	972.969
Shtator 2020	53.328	16.263	535.112	74.629	17.170	614.346
Ndryshimi vjetor (%)	-64,1	-78,6	-36,2	-61,2	-84,6	-36,9
Janar-Shtator 2019	1.274.940	697.478	7.673.581	1.285.244	728.440	7.707.770
Janar-Shtator 2020	521.254	169.675	3.444.012	524.151	188.284	3.608.229
Ndryshimi vjetor (%)	-59,1	-75,7	-55,1	-59,2	-74,2	-53,2

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.